

VENDIM
Nr. 44, datë 18.3.2020

**MBI DISA NDRYSHIME NË MARRËVESHJEN PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT
TË SHPËRNDARJES TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET OPERATORIT
TË SHPËRNDARJES TË ENERGJISË ELEKTRIKE (OSHEE) SH.A. DHE
FURNIZUESIT**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 69, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe nenit 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoritë Teknike, nr.37.6 Prot, datë 4.3.2020,”Mbi miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes të energjisë elektrike ndërmjet operatorit të shpërndarjes të energjisë elektrike (OSHEE) sh.a. dhe furnizuesit”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE me vendimin nr 24, datë 15.2.2017 dhe nr. 58, datë 15.4.2019, ka vendosur të miratojë marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet operatorit të shpërndarjes së energjisë elektrike (OSHEE) sh.a., dhe furnizuesit.

- OSSH sh.a. me shkresën e saj nr. 439 Prot, datë 14.2.2020, ka dërguar kërkesën për miratimin nga ERE të ndryshimit të palës përgjegjëse për Sigurimin e Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nga OSHEE në OSSH në marrëveshjen sipërcituar.

- Referuar nenit 72, të Ligjit nr. 45/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, përcaktohet se, “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” duhet të jetë i ndarë dhe i pavarur nga aktivitetet e tjera, të cilat nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen e energjisë elektrike

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 216, datë 11.10.2018, vendosi të bëjë transferimin e licencës për Operimin e Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, të OSHEE sh.a., me nr. 250, seria P14SH, miratuar nga ERE me vendimin nr. 96, datë 27.10.2014, tek shoqëria "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a., me afat vlefshmerie deri më datë 27.10.2044.

- OSSH sh.a si person juridik, është përgjegjës për operimin e sigurt dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zonë të caktuar dhe, kur është e aplikueshme, lidhjet e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe efikasitetin e energjisë.

- Bordi i ERE-s në shqyrtim të kërkesës së Shoqërisë OSHEE sh.a me vendimin, nr. 264, datë 20.12.2018, vendosi periudhën tranzitore prej 12 muaj, për bërjen efektive të transferimit të licencave

- Në vijim, me vendimin nr. 146, datë 18.12.2019, vendosi të miratojë kërkesën e shoqërisë për shtyrjen e periudhës tranzitore deri në datën 31.12.2019, me qëllim bërjen efektive të transferimit të licencave të operimit të sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike, të shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a., (OSHEE sh.a.), tek shoqëria "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a., dhe licencës së furnizimit të energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, tek shoqëria "Furnizuesi i Shërbimit Universal“ sh.a.

- Si rezultat i ndarjes së Shoqërisë OSHEE sh.a., si dhe i vendimeve të sipërcituara, në zbatim të urdhrit nr. 157, data 12.2.2018 të Ministrisë të Energjisë dhe Industrisë, Shoqëria "OSSH" sh.a., prej janarit 2020 vijon operimin në treg, si operator i veçantë, ndërkohë që edhe ligjërisht, përcaktohet tashmë si person juridik përgjegjës për veprimtaritë e kryera deri më sot nga kjo strukturë, pjesë e organizimit të OSHEE GROUP sh.a., dhe se të gjithë të drejtat dhe detyrimet që lindin nga Marrëveshja e Sigurimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike i kalojnë Shoqërisë OSSH sh.a.

- Me transferimin e licencës së aktivitetit të shpërndarjes shoqëria OSSH ka mbartur të gjithë të drejtat dhe detyrimet e operatorit të shpërndarjes në kuptim të aktivitetit të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

- Ndryshimi në këtë Marrëveshje, lidhet vetëm me zëvendësimin e palës përgjegjëse për kryerjen e aktivitetit të shpërndarjes dhe nuk modifikon apo tjetëron të drejta e detyrime të parashikuara në të për palët.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në *Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes të energjisë elektrike ndërmjet operatorit të shpërndarjes të energjisë elektrike (OSHEE) sh.a. dhe Furnizuesit*, si në vijim:

a) Kudo në marrëveshje, fjala shoqëria “OSHEE” sh.a., do të zëvendësohet me fjalën Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti